URDHËR
Nr. 459, datë 28.8.2026

PËR MIRATIMIN E MASAVE PËR REHABILITIMIN E MJEDISIT TË DËMTUAR[1]

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe të shkronjës "a", të pikës 4, të nenit 50, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e masave për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar, që merren nga operatorët përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur këtij vendimi dhe që është pjesë përbërëse e tij.
2. Në bazë të vlerësimit të dëmit mjedisor, Agjencia Kombëtare e Mjedisit, nëse e vlerëson të nevojshme, kërkon zbatimin e masave të tjera specifike, për sa kohë që ato garantojnë një nivel mbrojtjeje mjedisore të barasvlershëm ose më të lartë dhe janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Masat e parashikuara në këtë urdhër zbatohen në përputhje me aktet nënligjore që përcaktojnë veprimtaritë e rrezikshme për mjedisin dhe me legjislacionin për përgjegjësinë mjedisore.
4. Zbatimi i këtyre masave fillon pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të akteve nënligjore për përgjegjësinë mjedisore, të nxjerra në bazë dhe për zbatim të nenin 50 të ligjit për mbrojtjen e mjedisit.
5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj

Shtojca 1

MASAT PËR REHABILITIMIN E MJEDISIT TË DËMTUAR

Kjo shtojcë përcakton një kornizë të përbashkët që ndiqet për përzgjedhjen e masave më të përshtatshme për sigurimin e rehabilitimin të mjedisit të dëmtuar.

Masat për rehabilitimin e mjedisit të dëmtuar përfshijnë çdo veprim ose kombinim veprimesh, përfshirë masat lehtësuese, që synojnë rikuperimin, rehabilitimin ose zëvendësimin e burimeve natyrore të dëmtuara dhe/ose të shërbimeve të cenuara, si dhe sigurimin e një alternative ekuivalente ndaj këtyre burimeve natyrore ose shërbimeve, në përputhje me shkronjën "a", të pikës 4, të nenit 50, të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar.

Rikuperimi, përfshirë rikuperimin natyror, konsiston, në rastin e dëmit ndaj ujërave, llojeve të mbrojtura, habitateve natyrore, përfshirë pyjet, në kthimin e burimeve natyrore të dëmtuara dhe/ose të shërbimeve të cenuara në gjendjen bazë, ndërsa, në rastin e dëmit

[1] Ky urdhër përafron pjesërisht Direktivën 2004/35/EC, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 prill 2004, "Për përgjegjësinë mjedisore, në lidhje me parandalimin dhe riparimin e dëmit mjedisor", e ndryshuar nga Direktiva 2006/21/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 mars 2006, Direktiva 2009/31/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 prill 2009, Direktiva 2013/30/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 12 qershor 2013; Rregullorja (BE) 2019/1010 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 5 qershor 2019 dhe e korrigjuar nga Corrigendum.

ndaj tokës, në eliminimin e çdo rreziku të konsiderueshëm që mund të ndikojë negativisht në shëndetin e njeriut.

1. Rehabilitimi i mjedisit të dëmtuar në ujëra ose në lloje të mbrojtura apo habitate natyrore

Rehabilitimi i mjedisit të dëmtuar, në lidhje me ujërat, llojet e mbrojtura apo habitatet natyrore, përfshirë pyjet, realizohet përmes rikthimit të mjedisit në gjendjen bazë, nëpërmjet masave rehabilituese parësore, plotësuese dhe kompensuese, ku:

a) "Rehabilitim parësor" është çdo masë rehabilituese që rikthen burimet natyrore dhe/ose shërbimet e dëmtuara në gjendjen e mëparshme ose sa më afër saj;

b) "Rehabilitim plotësues" është çdo masë rehabilituese e ndërmarrë në lidhje me burimet natyrore dhe/ose shërbimet për të kompensuar faktin që rehabilitimi parësor nuk çon në rikthimin e plotë të burimeve natyrore dhe/ose shërbimeve të dëmtuara;

c) "Rehabilitim kompensues" është çdo veprim i ndërmarrë për të kompensuar humbjet e përkohshme të burimeve natyrore dhe/ose shërbimeve që ndodhin nga data e shkaktimit të dëmit deri në momentin kur rehabilitimi parësor të arrijë efektin e tij të plotë;

d) "Humbje të përkohshme" janë humbjet që rrjedhin nga fakti që burimet natyrore dhe/ose shërbimet e dëmtuara nuk janë në gjendje të kryejnë funksionet e tyre ekologjike ose të ofrojnë shërbime për burime të tjera natyrore, ose për publikun deri në momentin kur masat parësore ose plotësuese kanë dhënë efekt. Këto nuk përbëjnë kompensim financiar për publikun.

Kur rehabilitimi parësor nuk çon në rikthimin e mjedisit në gjendjen e mëparshme, ndërmerren masa rehabilituese plotësuese. Përveç kësaj, ndërmerren masa rehabilituese kompensuese për të kompensuar humbjet e përkohshme.

Rehabilitimi i mjedisit të dëmtuar, në lidhje me ujërat ose llojet e mbrojtura apo habitatet natyrore përfshirë pyjet, nënkupton, gjithashtu, eliminimin e çdo rreziku të konsiderueshëm për shëndetin e njeriut.

1.1 **Objektivat e rehabilitimit**

1.1.1 Rehabilitimi parësor është rikthimi i burimeve natyrore dhe/ose shërbimeve të dëmtuara në gjendjen e mëparshme ose sa më afër saj. Si burime natyrore merren në konsideratë llojet e mbrojtura, habitatet natyrore, pyjet, ujërat dhe toka. Këto masa janë masa që zbatohen gjithmonë të parat dhe synojnë rikthimin e strukturës dhe funksionit ekologjik, si më poshtë:

a) Për biodiversitetin:

i. ripyllëzim dhe restaurim i vegjetacionit me specie autoktone;

ii. rivendosje e habitateve natyrore (p.sh.: ligatina, dune, livadhe);

iii. rikthim i strukturës së tokës, mikrohabitateve dhe funksioneve ekologjike;

iv. ripopullim i faunës me specie vendase, kur është ekologjikisht i justifikuar;

v. heqje e specieve invazive dhe rehabilitim i zonës pas ndërhyrjes.

b) Për ujërat:

i. pastrim i trupave ujorë nga ndotësit dhe mbetjet;

ii. rivendosje e shtratit natyror dhe e morfologjisë së lumenjve;

iii. rikthim i regjimit natyror hidrologjik;

iv. riparim dhe rikthim i habitateve ujore.

c) Për tokën:

i. heqje dhe trajtim i tokës së ndotur;

ii. dekontaminim *in situ*, sipas natyrës së ndotjes;

iii. stabilizim fizik/kimik i ndotjes;

iv. rikthim i funksioneve ekologjike të tokës.

1.1.2 Objektivi i rehabilitimit plotësues është të sigurojë një nivel të ngjashëm burimesh natyrore dhe/ose shërbimesh, përfshirë, sipas rastit edhe në një vend alternativ, sikur vendi i dëmtuar të ishte rikthyer në gjendjen e mëparshme. Kur është e mundur dhe

e përshtatshme, vendi alternativ duhet të jetë i lidhur gjeografikisht me vendin e dëmtuar, duke marrë parasysh interesat e popullsisë së prekur. Këto masa synojnë sigurimin e burimeve ose shërbimeve mjedisore të barasvlershme, në vendin e dëmtuar dhe/ose në zona alternative ekologjikisht të krahasueshme, si më poshtë:

a) Për biodiversitetin:

i. krijim i habitateve të reja ekuivalente në zona të tjera;

ii. përmirësim funksional i habitateve ekzistuese;

iii. zgjerim i sipërfaqeve të mbrojtura;

iv. korridore ekologjike për lidhjen e popullatave.

b) Për ujërat:

i. krijim i ligatinave kompensuese;

ii. restaurim i një trupi tjetër ujor me funksion ekologjik ekuivalent;

iii. përmirësim i statusit ekologjik të një segmenti tjetër ujor.

c) Për tokën:

i. rikuperim ekologjik i tokave të degraduara në zona të tjera;

ii. rehabilitim i habitateve dhe tokave me funksion mjedisor ekuivalent.

1.1.3 Rehabilitimi kompensues synon kompensimin e humbjes së përkohshme të burimeve natyrore dhe/ose shërbimeve mjedisore gjatë periudhës nga shkaktimi i dëmit deri në rikthimin e plotë të tyre. Këto masa nuk përbëjnë dëmshpërblim apo kompensim financiar, nuk zëvendësojnë masat parësore apo plotësuese dhe zbatohen paralelisht me to, si më poshtë:

a) Për biodiversitetin:

i. krijimi i habitateve të përkohshme;

ii. rritja e nivelit të mbrojtjes së popullatave ekzistuese;

iii. përmirësim i shërbimeve mjedisore gjatë periudhës tranzitore.

b) Për ujërat:

i. shtimi i burimeve ujore alternative;

ii. përmirësimi i përkohshëm i cilësisë ekologjike të trupave të tjerë ujorë;

iii. masa për ruajtjen e biodiversitetit ujor gjatë periudhës tranzitore.

c) Për tokën:

i. krijimi i funksioneve ekologjike të përkohshme;

ii. përmirësimi i shërbimeve ekosistemore alternative.

1.1.4 Masa emergjente për eliminimin e kërcënimit të menjëhershëm synojnë parandalimin, kufizimin ose eliminimin e një kërcënimi të menjëhershëm për dëmtim mjedisor dhe zbatohen pa vonesë, para ose pavarësisht masave të rehabilitimit, si më poshtë:

a) Masa teknike dhe operative:

i. ndërprerja e menjëhershme e aktivitetit që shkakton ose rrezikon të shkaktojë dëmtim mjedisor;

ii. izolimi dhe stabilizimi i burimit të ndotjes;

iii. ndalimi i shkarkimeve, rrjedhjeve ose përhapjes së ndotësve;

iv. vendosja e barrierave fizike ose teknike mbrojtëse;

v. grumbullimi, neutralizimi ose largimi i substancave të rrezikshme;

vi. heqja e materialeve të rrezikshme;

vii. stabilizimi emergjent i zonës së dëmtuar.

1.1.5 Masa administrative:

a) Urdhërim i masave të përkohshme;

b) Kufizim i aksesit publik;

c) Monitorim intensiv emergjent.

1.2 **Identifikimi i masave rehabilituese**

1.2.1 Për identifikimin e masave rehabilituese parësore duhet të merren në konsideratë opsione që përfshijnë veprime për rikthimin e drejtpërdrejtë të burimeve natyrore dhe

shërbimeve në gjendjen e mëparshme, në një afat kohor të përshpejtuar ose përmes rehabilitimit natyror.

1.2.2 Për identifikimin dhe përcaktimin e shkallës së masave rehabilituese plotësuese dhe kompensuese, merren në konsideratë qasjet e ekuivalencës burim me burim ose shërbim me shërbim. Sipas këtyre qasjeve, së pari merren në konsideratë shërbimet që ofrojnë burime natyrore apo shërbime të të njëjtit lloj, të së njëjtës cilësi dhe sasie si ato të dëmtuara. Kur kjo nuk është e mundur, sigurohen burime natyrore dhe/ose shërbime alternative. Për shembull, një ulje e cilësisë mund të kompensohet me rritje të sasisë së masave rehabilituese.

1.2.3 Kur nuk është e mundur të përdoren qasjet e para të bazuara në ekuivalencën burim me burim ose shërbim me shërbim, atëherë përdoren teknika alternative të vlerësimit. Autoriteti kompetent mund të përcaktojë metodën e vlerësimit, për shembull vlerësimin monetar, për të përcaktuar shkallën e masave plotësuese dhe kompensuese të nevojshme për riparimin e dëmit. Nëse vlerësimi i burimeve natyrore dhe/ose i shërbimeve të humbura është i realizueshëm, por që vlerësohet se zëvendësimit i burimeve natyrore dhe/ose i shërbimeve nuk mund të kryhet brenda një afati të arsyeshëm kohor ose me një kosto të arsyeshme, atëherë autoriteti kompetent mund të zgjedhë masa riparuese, kostoja e të cilave është e barasvlershme me vlerën monetare të vlerësuar të burimeve natyrore dhe/ose shërbimeve të humbura.

1.2.4 Masat rehabilituese plotësuese dhe kompensuese duhet të projektohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë burime natyrore dhe/ose shërbime shtesë, duke reflektuar preferencat kohore dhe profilin kohor të masave rehabilituese. Për shembull, sa më e gjatë të jetë periudha deri në arritjen e gjendjes së mëparshme, aq më i madh duhet të jetë niveli i masave rehabilituese kompensuese (në kushte të barabarta).

1.3 **Zgjedhja e opsioneve rehabilituese**

1.3.1 Opsionet e arsyeshme rehabilituese vlerësohen, duke përdorur teknologjitë më të mira të disponueshme, mbi bazën e kritereve të mëposhtme:

i. ndikimi i çdo opsioni në shëndetin dhe sigurinë publike;

ii. kostoja e zbatimit të opsionit;

iii. mundësia e suksesit të çdo opsioni;

iv. shkalla në të cilën çdo opsion parandalon dëmet e ardhshme dhe shmang dëmet dytësore si rezultat i zbatimit të tij;

v. shkalla në të cilën çdo opsion përfiton secilin komponent të burimit natyror dhe/ose shërbimit;

vi. shkalla në të cilën çdo opsion merr në konsideratë shqetësimet përkatëse sociale, ekonomike dhe kulturore, si dhe faktorë të tjerë përkatës specifikë për zonën;

vii. koha e nevojshme që rehabilitimi i mjedisit të dëmtuar të jetë efektiv;

viii. shkalla në të cilën çdo opsion arrin rikthimin e vendndodhjes së dëmit mjedisor;

ix. lidhja gjeografike me vendin e dëmtuar.

1.3.2 Gjatë vlerësimit të opsioneve të ndryshme rehabilituese të identifikuara, mund të zgjidhen masa rehabilituese parësore që nuk e rikthejnë plotësisht ujin, llojet e mbrojtura, habitatin natyror, përfshirë pyjet në gjendjen e mëparshme ose që e rikthejnë atë më ngadalë. Ky vendim mund të merret vetëm nëse burimet natyrore dhe/ose shërbimet e humbura në vendin parësor, si rezultat i këtij vendimi, kompensohen përmes rritjes së masave plotësuese ose kompensuese për të siguruar një nivel të ngjashëm burimesh natyrore dhe/ose shërbimesh si ato të humbura. Kjo ndodh, për shembull, kur burime dhe/ose shërbime natyrore ekuivalente mund të sigurohen diku tjetër me kosto më të ulët. Këto masa shtesë rehabilituese përcaktohen në përputhje me rregullat e përcaktuara në pikën 1.2.2 më lart.

1.3.3 Pavarësisht rregullave të përcaktuara në pikën 1.3.2 më sipër dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka të drejtë të vendosë që të mos merren masa të mëtejshme rehabilituese, nëse:

a) masat rehabilituese të marra tashmë sigurojnë që nuk ekziston më asnjë rrezik i rëndësishëm për ndikim negativ në shëndetin e njeriut, në ujëra ose në lloje të mbrojtura dhe në habitate natyrore; dhe

b) kostoja e masave rehabilituese që do të duheshin marrë për të arritur gjendjen e mëparshme ose një nivel të ngjashëm do të ishte joproporcionale në raport me përfitimet mjedisore që do të arriheshin.

2. Rehabilitimi i dëmit në tokë

2.1 Masat e nevojshme për rehabilitimin e tokës së ndotur merren për të siguruar, të paktën, që ndotësit përkatës të hiqen, të kontrollohen, të kufizohen ose të reduktohen, në mënyrë që toka e ndotur, duke marrë parasysh përdorimin e saj aktual ose përdorimin e miratuar në të ardhmen në kohën e shkaktimit të dëmit, të mos përbëjë asnjë rrezik të konsiderueshëm me ndikim negativ të pakthyeshëm në shëndetin e njeriut.

2.2 Prania e këtyre rreziqeve vlerësohet përmes procedurave të vlerësimit të rrezikut, duke marrë parasysh karakteristikat dhe funksionin e tokës, llojin dhe përqendrimin e substancave të dëmshme, përgatitjeve, organizmave ose mikroorganizmave, rrezikun e tyre dhe mundësinë e përhapjes së tyre.

2.3 Përdorimi përcaktohet mbi bazën e rregullave për përdorimin e tokës ose rregullave të tjera përkatëse, në fuqi, nëse ka, në kohën kur ka ndodhur dëmi.

2.4 Nëse përdorimi i tokës ndryshohet, merren të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar çdo ndikim negativ në shëndetin e njeriut.

2.5 Nëse mungojnë rregullat për përdorimin e tokës ose rregulla të tjera përkatëse, natyra e zonës përkatëse ku ka ndodhur dëmi, duke marrë parasysh zhvillimin e pritshëm të saj, përcakton përdorimin e zonës specifike.

2.6 Duhet të merret në konsideratë edhe opsioni i rehabilitimit natyror, pra një opsion në të cilin nuk ndërmerret asnjë ndërhyrje e drejtpërdrejtë njerëzore në procesin e rehabilitimit.